



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 40, datë 09.05.2022

PËR

MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 2'303'173'480 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.181, DATË 30.03.2022 "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEZA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUIJË"

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.181, datë 30.03.2022 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Kruijë", si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e detajimit të fondit prej 2'303'173'480 (dy miliardë e treqind e tre milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.181, datë 30.03.2022 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të

banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, për t’u përdorur në formën e transfertës së pakushtëzuar për objektet të ndara sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga bashkia Durrës, në masën 483’911’184 (katërqind e tetëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime në bashkinë Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dymishi




U shpall sot me datë 10.05.2022



Tabela e detajimit te fondit

Emertimi i projektit	Fondi ne leke
Riforcimi pallateve me kod gis: 20590,22363,20402,19065,19659, 21258,21167,47053,38766,19068, 21281,22369 riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Manez të Xhelal Sefa.	412,792,063
Mbikqyrje	6,402,919
Kolaudim	619,637
Riforcimi pallateve me kod gis: 25759,25583,22842,22243,22248, 22866,24812,22707,25248,22721, 24821,22245,22299	424,861,589
Mbikqyrje	6,626,401
Kolaudim	641,265
Riforcimi pallateve me kod gis: 5407,25387,26969,1511,25947, 26972,27307,26764	417,302,520
Mbikqyrje	5,868,819
Kolaudim	567,950
Riforcimi pallateve me kod gis: 24, 5703, 5414, 6169, 94, 80, 99	503,102,130
Mbikqyrje	6,995,248
Kolaudim	676,960
Riforcimi pallateve me kod gis: 7330, 5630, 851, 7294, 5541, 60069, 7314, 117, 5638	508,845,578
Mbikqyrje	7,264,393
Kolaudim	606,009
TOTALI	2,303,173,480





BASHKIA DURRE
16.05.22 Nr 3882/3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 427/8 prot.

Durrës, më 16.05.2022



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

BASHKISË DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.40 datë 09.05.2022 “Për miratimin e detajimit të fondit prej 2.303.173.480 lekë pa TVSH në zbatim të VKM Nr 181 dt 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riorcimit të njësjive individuale të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

